



Perspektiva juaj
është sfida jonë!

Fondi më i ri në fushën e investimeve

Raport Muaji Shkurt 2023

Informacion bazë

Administrimi i Fondit	Raiffeisen Invest sh.a
Monedha	LEK
Datë Lancimi	20 Gusht 2018
Datë e mbarimit te Ofertes Fillestare	03 Shtator 2018
Vlera fillestare e kuotës	1,000
Shuma fillestare minimale	30,000
Shuma minimale pasuese	10,000

Komisione dhe Tarifa

Tarifë në hyrje	0%
Tarifë në dalje	2% (cdo shlyerje para 2 viteve)
Tarifë Administrimi në vit	Deri ne 1.15% e vleres neto te asetëve

Tarifa te tjera te vazhdueshme **Referojuni prospektit te fondit**

Komisione/tarifa e vazhdueshme **1.28% per vitin 2022**

Kosto për transfertë fondesh nga palë të treta **Referojuni informacionit ne degët e RBAL**

Objektivi i investimit dhe profili i investitorit

Objektivi i Fondit është të maksimizoje kthimin total afatmesëm, duke synuar të ruajë kapitalin e investitorit dhe të sigurojë likuiditet të mjaftueshëm.

Fondi synon të ketë një portofol investimesh të përqëndruar kryesisht në instrumente borxhi të emetuara ose garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.


Për të maksimizuar kthimin total nga investimi, Fondi synon investime afatgjata dhe për këtë arsye, fondi investon të paktën 50 – 80% të asetëve ne obligacione afatgjatë te Qeverisë shqiptare.

Shifra e tarifas së vazhdueshme 1.28% mbështetet në shpenzimet për vitin e mbyllur më 31.12.2022. Kjo shifër mund të ndryshojë nga viti në vit. Tarifa totale e vazhdueshme nuk mund te kalojë maksimumin prej 1.4% ne vit te vlerës neto të asetëve te fondit.

Kostot e transaksioneve janë sipas kushteve të punës të palëvendërmjetësuese dhe nuk përfshihen në llogaritjen e komisioneve dhe tarifave të vazhdueshme, por ato i ngarkohen Fondit.

Profili i Rrezikut dhe Përfitimit

Rrezik i ulët Rrezik i lartë
Përfitimet tipike më të ulëta Përfitimet tipike më të larta




Profili i parashikuar i Rrezikut dhe Përfitimit të fondit Raiffeisen Vizion i përket kategorisë së tretë. Ky nivel i treguesit është rezultat i aplikimit të politikës së investimit të fondit me të dhënat historike të normave të interesit për 5 vitet e fundit. Treguesi i rrezikut dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel rreziku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes të luhatshmërisë. Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa rrezik. Ky tregues ka për qëllim tju informoje mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës së fondit. Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e rrezikut në të ardhmen.

Të dhëna për Fondin në 28.02.2023

Vlera Neto e Aseteve	9,314,260,464
Numri i investitoreve	3,868
Cmimi i Kuotes	1,101.5638
*Kthimi vjetor neto nga investimi (28.02.2022 - 28.02.2023)	-2.59%

*Tarifa e administrimit dhe tarifat e tjera të vazhdueshme zbriten përpara llogaritjes së kthimit nga investimi

Struktura e portofolit të investimeve në 28 Shkurt 2023



Ne kuader të politikës së investimit të fondit Vizion, investimet kryhen kryesisht në obligacione thesari, të emetuara ose garantuara nga Qeveria shqiptare, përmes pjesëmarrjes në ankandet e tregut primar dhe transaksioneve në tregun sekondar.

Politika e investimit parashikon që të paktën 50 – 80 % e asetëve të fondit të investohen në obligacione afatgjate të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë. Fondi mban një pjesë të asetëve në depozita afatshkurtra për të plotësuar në çdo kohë nevojat për likuiditet të investitoreve. Vlera neto e asetëve të fondit është në nivelin e LEK 9.3 miliardë në datë 28 Shkurt 2023.

Instrumenti	Ne % të Aseteve të Fondit
Obligacione Thesari	85.61%
Depozita / Llogari rrjedhese/ Te arketueshme	14.39%

Bonot e thesarit 12 mujore emetohen dy here në muaj; Obligacionet 2 vjeçare një here në muaj; 7 dhe 10 vjeçare janë me të rralla, afersisht një here në tre muaj. Qeveria organizon ankande të obligacioneve referencë 5 dhe 3-vjeçare me frekuencë një here në 2 muaj për secilin maturitet.

Zhvillimet dhe ecuria e normave te interesit te titujve te Qeverise Shqiptare gjate muajit Shkurt



Banka e Shqipërisë ka marr vendimin për të mbajtur normën bazë të interesit të pandryshuar në nivelin 2.75%. Politika monetare e ndjekur këte periudhe ka nisur të ketë efektet e saj, duke bërë që inflacioni të shënojë rënie gjatë muajve të fundit. Në Shkurt norma e inflacionit ra në 7.1%. Normat e interesit të bonove dhe obligacioneve të Qeverisë Shqiptare në të cilat fondi Vizion investon kanë ndryshuar trend duke rënë në fillim të vitit 2023. Kjo rënie e normave pritet të vazhdojë gjatë pjesës së parë të vitit dhe me pas të stabilizohen gjatë pjesës së dytë. Asetet e Fondit Vizion janë të investuara vetëm në bono dhe obligacione të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe për këtë arsye fondi është i ekspozuar ndaj ndryshimeve në normat e interesit të këtyre titujve, ndaj rënia e normave të interesit ka patur një ndikim pozitiv në portofolin e investimeve dhe si rrjedhojë çmimi i kuotës së fondit shënoi një rritje me +5.73% gjatë muajit Shkurt.

Përgjatë muajit Shkurt në tregun vendas, normat e interesit të titujve të emetuar nga Qeveria Shqiptare patën një trend rënës, sidomos për titujt afatgjatë.

Yieldi i Bonos së Thesarit 12-mujore rezultoi në 3.984% duke rënë me 0.88% në krahasim me ankandin e muajit Janar. Yieldi i Bonove të Thesarit 3 dhe 6 mujore u ulën përkatësisht me 0.27% dhe 1.12% në krahasim me ankandet paraardhëse.

Për sa i përket obligacioneve, ankandi i obligacionit 2 vjeçar rezultoi në 5.35%, duke rënë me 0.45% krahasuar me ankandin paraardhës. Ankandi i obligacionit referencë 3-vjeçar rezultoi në 4.984%, duke rënë me 1.30% krahasuar me ankandin e fundit. Ankandi i obligacionit 7-vjeçar rezultoi në 6.00%, duke rënë me 1.98% krahasuar me ankandin paraardhës dhe obligacioni 15-vjeçar rezultoi në 6.80%, duke rënë me 2.15% krahasuar me ankandin paraardhës.

Grafiket më poshtë japin një pasqyrë të ecurisë së normave të interesit të bonove dhe obligacioneve të thesarit të emetuar nga Qeveria Shqiptare gjatë periudhës 1-vjeçare Shkurt 2022 – Shkurt 2023. Për obligacionet referencë 3 dhe 5 vjeçare janë paraqitur yield-et fikse të perlogaritura nga kuotimet e kontributoreve në fund të muajit Shkurt.




Performanca e fondit dhe ecuria e çmimit të kuotës deri ne 28 Shkurt 2023

Kthimi neto me baze vjetore, per periudhen 28 Shkurt 2022 – 28 Shkurt 2023 eshte **-2.59% ndersa kthimi vjetor per nje periudhe 2 vjecare eshte **1.00% p.a.****

Çmimi i kuotes se fondit Vizion eshte rritur ndjeshem me **+5.73%** gjate muajit Shkurt, si pasoje e renies se normave te interesit te bonove dhe obligacioneve te emetuara nga Qeveria Shqiptare. Fondi ka rikuperuar nje pjese te mire te humbjeve te vitit te kaluar shkaktuar nga rritja e normave te interesit te titujve te Qeverise Shqiptare.


Duhet patur parasysh se norma e kthimit ndryshon ne varesi te kushteve te tregut, sic jane ndryshimet e normave te interesit te titujve te borxhit te emtuar nga Qeveria Shqiptare. Keshtu kur normat e interesit ne treg rriten, vlera e titujve te portofolit ulet dhe per rrjedhoje ulet dhe norma e kthimit per periudhen e kaluar. E kunderta ndodh kur normat e interesit ulen. Per pasoje, çmimi i kuotes mund te jete i luhatshem. Luhatshmeria eshte pjese e natyrshme e fondeve te investimit dhe eliminimi i saj eshte i pamundur, keshtu çmimi i kuotes mund edhe te bjere, jo vetem te rritet.

Ecuria e çmimit të kuotes Fondi Raiffeisen Vizion



Ne 28 Shkurt 2023	1 Vit	2 Vjet	3 Vjet	Qe nga lancimi i fondit (3 Shtator 2018)
Ne % kthim vjetor i periudhes (p.a.)	-2.59%	1.00%	1.20%	2.18%

Kthimi vjetor historik i Fondit Raiffeisen Vizion per çdo vit



Fondi Vizion aplikon nje periudhe minimale qendrimi ne fond prej 2 vitesh. Cdo shlyerje perpara permbushjes se periudhes 2-vjet, do te jetë subjekt i nje tarife dalese prej 2% e vleres se kuotave te shlyera.

Pertej minimumit kohor te qendrimit ne fond, Investitoret e fondit Vizion dhe te gjithe fondeve te administruara nga Raiffeisen Invest keshillohen te kene nje horizont sa me te gjate investimi per te perfituar nje kthim optimal nga investimi dhe ne kete menyre ne periudhe afatmesme apo afatgjate te kene mundesi te rikuperojne edhe efektet negative te krijuara afatshkurter.

Per fondin Vizion ky horizont i rekomanduar i qendrimit ne fond eshte te pakten 3 vjet, duke patur parasysh natyrën afatgjatë të investimeve të parashikuara në strategjinë e investimit të fondit dhe ne menyre qe te permbushet objektivi i performancës së fondit.

Investitoret inkurajohen qe te ruajne investimin e tyre duke mos ndryshuar objektivin e qendrimit ne fond te nxitur nga situata jo e zakonshme e krijuar nga konflikti gjeopolitik dhe inflacioni i larte, sepse ne kete menyre nuk do te rrezikojne te dalin nga fondi ne momentin e gabuar per investimin e tyre.

Të dhënat per kthimin nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë nje premtim apo garanci per kthimin ne te ardhmen. Te gjithe shembujt e tjere numerike, jane perdorur per qellime ilustrative dhe analize te te dhenave historike, dhe nuk duhen perdorur nga investitoret per te nxjerre konkluzione per te ardhmen.

Investitorët e mundshëm duhet të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit. Raiffeisen Invest dhe forca shitëse e fondit nuk garantojne nje kthim te caktuar te fondit.

Informacioni mbi cmimin e përditësuar të kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Raiffeisen Invest sha., në web site www.raiffeisen-invest.al ose në degët e Raiffeisen Bank në Shqipëri.